

1.1 Statuti I "Rrjeti për Përgjegjësi Shoqërore Korporative"-Kosovo CSR Network

Ky statut do të qeverisë shoqatën jo-profitabile **Rrjeti për Përgjegjësi Shoqërore Korporative/Kosovo CSR Network**, të themeluar në pajtim të Ligjit Nr.04/L-57 për Lirinë e Asociimit ne Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1

Emri, forma dhe adresa

1.2 Organizata do të quhet **Rrjeti për Përgjegjësi Shoqërore Korporative - Kosovo CSR Network**

1.3 Ajo mund të njihet edhe si **Kosovo CSR Network**

1.4 Organizata është shoqatë jo-për përfitim, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr.04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

1.5 Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e cfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet joprofitabile të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të vecanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona e kanë bërë për këtë organizatë.

1.6 Ndonjë transakcion në mes të anëtarëve, anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, personi ose nëpunësi dhe organizatës duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.

1.7 Organizata e ka zyrën e saj qendrore në **Rrugën Tringe Smajli Nr.21, Prishtinë, Kosovë**.

Neni 2

Themeluesit

1 Themelues të organizatës janë:

2.1.1 "SHARRCEM" SH.P.K. me seli në Hanin e Elezit, rruga Lagja e Punëtorëve, me numër të regjistrimit të biznesit 70708396.

2.1.2 RAIFFEISEN BANK KOSOVO J.S.C me seli në Prishtinë, rruga UCK nr.51, me numër të regjistrimit të biznesit 70025959.

2.1.3 AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN KOSOVO (ODA EKONOMIKE AMERIKANE NË KOSOVË), organizatë jo-qeveritare me zyrë në Prishtinë, rruga Fehmi Agani 36/3, me numër të regjistrimit të organizatës 5102432-0 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike.

2.2 Përfaqësuesi i autorizuar i organizatës në Kosovë është Drejtori/ja Ekzekutive.

2.3 Përfaqësuesi i autorizuar autorizohet nga kuvendi i anëtarëve dhe duhet të përfaqësojë organizatën në Kosovë dhe jashtë vendit, dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës.

2.4 Përfaqësuesi i autorizuar është përgjegjës/se për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruarat të organizatës.

Neni 3

Qëllimi

3.1 Organizata është themeluar me qëllim të mbështetjes dhe kontribuimit në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik përmes promovimit të përgjegjësisë shoqërore korporative në shoqërinë Kosovare. Rrjeti PSHK si një organizatë jo-fitimprurëse, jo-qeveritare e themeluar nga anëtarët e saj me qëllim që ta mbështes kontributin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, përmes promovimit të përgjegjësisë shoqërore korporative do të jetë në përputhje me parimet Global Compact.

3.2 Në përpjekjet e saj për të përmbushur qëllimin e përcaktuar në Nenin 6, Rrjeti i CSR do të:

- Punoj në ngritjen e vetëdijes për çështjet e CSR në Kosovë;
- Hulumtoj në fushën e CSR dhe parimeve Global Compact;
- Krijoj forum ku anëtarët do t'i diskutojnë pikëpamjet e CSR dhe çështjet e interes të përbashkët si dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet anëtarëve për avancimin e Përgjegjësisë Shoqërore Korporative në Kosovë;
- Ofroj asistencë teknike për kompanitë anëtare dhe shpërndarja e informacioneve rreth CSR
- Bashkëpunoj me Qeverinë e Kosovës dhe akterët tjerë relevant për hartimin e një politike kombëtare CSR të Kosovës;
- Ndhijoj në ngritjen e vetëdijës për CSR ndërmjet bizneseve dhe palëve të tjera të interes përmes fushatave komunikuese;
- Ndihmoj në ndërtimin e kapaciteteve të bizneseve të tjera për të integruar politikat e CSR në kompanitë e tyre;
- Promovimi i politikave dhe strategjive koherente të CSR bazuar në integritet, vlera të shëndosha dhe një qasje afatgjatë;
- Promovoj nevojën e ngritjes së një sistemi të rangimit të kompanive që ndërmarrin aktivitete të CSR-Indeksi i CSR.

Neni 4

Anëtarësimi

4.1 Anëtarësimi në rrjet është i hapur për Kompanitë që operojnë në Kosovë; organizatat fitim-prurëse dhe jo-fitimprurëse (OJQ) që operojnë në Kosovë.

4.2 Rrjeti nuk është diskriminues pavarësisht prej races së përfaqësuesve, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

- 4.3** Kuvendi i anëtarëve do të vendosë për tarifat e anëtarimit. Kuvendi gjithashtu vendosë për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarimit, përfshirë marrjen e masave të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga organizata në rast të mospagesës së anëtarësisë.
- 4.4** Për t'u anëtarësuar në organizatë, secili i interesuar duhet të pranojë Statutin dhe Qellimin e organizatës, dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës.
- 4.5** Çdo anëtar i Rrjetit do të nënshkruajë Deklaratën e Rrjetit CSR për Qeverisjen e Mirë të Korporatave.
- 4.6** Anëtarësimet e reja në Rrjet duhet të referohen nga anëtarët aktual të Rrjetit.
- 4.7** Pranimi i anëtarëve të rinj në rrjetin PSHK duhet të aprovohet nga Kuvendi. Letërpranimi për anëtarët e rinj do të përcillet së bashku me paketën e anëtarësisë dhe faturën e anëtarësisë për vitin respektiv.
- 4.8** Anëtarësimi i ndonjë anëtarit gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit në rast të mos-respektimit të statutit apo dokumenteve të tjera të dala nga Kuvendi.

Neni 5 Kuvendi i Anëtarëve

- 5.1** Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.
- 5.2** Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politiken dhe çështjet finaciare të organizatës.
- 5.3** Përpos kompetencave që ka Kuvendi i Anëtarëve sipas statutit, ai gjithashtu ka edhe këto kompetenca të zgjedhë anëtarët e bordit të drejtorëve, të zgjedhë përfaqësuesin e autorizuar të Rrjetit PSHK, të aprovoj raportet prej zyrtarëve të rrjetit PSHK, të aprovoj përvetësimin e pasurisë, të aprovoj tarifat e anëtarësisë në Rrjet dhe të aprovoj Buxhetin e Rrjetit.
- 5.4** Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në Bordin e drejtorëve ose ndonjë organ tjetër ose edhe të punësuar të organizatës, me veprimin e shumicës së anëtarëve të tij me përjashtim të atyre të drejtave për të cilat nuk lejohet sipas ligjit për ORJ-të.

Neni 6 Mbledhjet e Kuvendit Të Anëtarëve

- 6.1** Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithëshme vjetore (MPV) ku do shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, kuvendi i anëtarëve shqyrton dhe miraton planin strategjik të rrjetit çdo tre vite.
- 6.2** Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në mbledhje të tjera kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga Bordi i Drejtorëve. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Drejtorit Ekzekutiv që të njoftojë të gjithë anëtarët për mbledhjen e Kuvendit në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin 6.3.
- 6.3** Lajmërimi me shkrim (në mënyrë elektronike) për MPV dhe/ose mbledhje të tjera të kuvendit, përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'ju shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku 7 ditë pune para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
- 6.4** Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më së paku shumicës së anëtarëve.

6.5 Të gjitha mbledhjet e kuvendit do të kryesohen nga Kryetari i Bordit të Rrjetit; ose, në mungesë të Kryetarit, Zëvendës Kryetari; ose, në mungesë të të dyve, nga një anëtar tjetër i Bordit.

6.6 Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6.7 Vetëm personi i autorizuar të përfaqësoj kompaninë/organizatën/entitetin anëtar ka të drejtë të marr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të anëtarëve.

6.8 Personi i autorizuar si përfaqësuesi i kompanisë/organizatës/entitetit anëtarë ka të drejtë të përfaqësoj vetëm një entitet.

6.9 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, vendimet do të merren me shumicë të thjeshtë votash të atyre që janë të pranishëm dhe kanë të drejtë të votojnë. Kryesuesi i kuvendit do të ketë votim vendimtar në rast të rezultati të barabartë të votimit, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me aktet tjera nenligjore.

6.10 Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

6.11 Nëse përfaqësuesi zyrtar nuk mund të jetë prezent në mbledhje të kuvendit, ai mund të autorizoj zëvendësues tjetër për mbledhje duke e njoftuar me shkrim Drejtorin Ekzekutiv jo më vonë se njëzet e katër (24) orë para takimit përkatës.

6.12 Anëtarët mund gjithashtu të votojnë me postë elektronike.

6.13 Anëtarët të cilët dëshirojnë të votojnë me postë elektronike duhet të informojnë Drejtorin Ekzekutiv në mënyrë elektronike për dëshirën e tyre për të votuar në këtë mënyrë brenda 48 orëve pas dërgesës së njoftimit për mbledhjen e Kuvendit ku është parashikuar votim nga kuvendi. Listat e votimit do të dërgohen në mënyrë elektronike të Anëtarët që bëjnë kërkesa të tilla se paku tre dite përpara takimit përkatës. Votat e përfunduara do të kthehen me postë elektronike të Drejtorit Ekzekutiv dhe Kryetari i Bordit jo më vonë se njëzet e katër (24) orë para takimit përkatës.

Neni 7

Bordi i Drejtorëve

7.1 Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

7.2 Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve do të ketë gjithashtu edhe të kontrolloj implementimin e qëllimit dhe aktiviteteve të parapara në statut, të mbikëqyr shpenzimet e organizatës në përputhje me buxhetin e aprovuar nga Kuvendi, t'i përcaktoj kompetencat dhe detyrat e çdo përfaqësuesi të cilat duhet të votohen nga Kuvendi duke rekomanduar ndryshime në këto nenligjore në Kuvend, të propozoj Drejtorin Ekzekutiv dhe mbikëqyrjen e punës së tij, përgatitjen e Programit Vjetor të Rrjetit, së bashku me buxhetin mbështetës dhe paraqitjen e tij në Kuvend për miratim.

7.3 Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm.

7.4 Bordi i Drejtorëve do të udhëheqë dhe mbikëqyrë funksionimin e përgjithshme të rrjetit, si përfaqësues të zgjedhur në mënyrë të rregullt të Kuvendit.